

## **POLITIKA E VEZHGIMIT ME KAMERA (CCTV)**

Kompania e shërbimit privat të sigurisë fizike **Bahiti-G** përdor sistemin e saj të mbikëqyrjes video (CCTV). Për vetë llojin e aktivitetit të kompanisë sone i cili është polici private, Bahiti-G e ka të domosdoshme survejimin e ambienteve të saj, me qëllimin kryesor Sigurinë dhe Mbrojtjen e pronës, asetëve, personelit, vizitorëve dhe kontrollit të hyrje-daljes në ambientet e saj.

Sistemi i mbikëqyrjes me video ofron siguri dhe ndihmon në parandalimin, pengimin dhe zbulimin e çdo aksesit fizik të paautorizuar, duke përfshirë zonat e vendosura nën mbikëqyrje ose mbrojtje, infrastrukture IT ose informacion operacionale, në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e vjedhjes së pajisjeve ose pronës që i përkasin kompanisë, vizitorëve ose stafit të saj ose veprimeve që kërcënojnë sigurinë e vizitorëve apo stafit që punojnë në mjediset.

Baza ligjore:

Ligji për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, nr.9887, datë 10.03.2008

♣ Udhezim nga ministria e brendshme nr.134, datë 10.03.2017, për përcaktimin e masave shtesë të sigurisë,

♣ Udhezimi nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhenave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar;

♣ Udhezimi nr. 46, datë 28.3.2017 Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhenave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Kamerat filmojnë në mënyrë të pandërprerë:

- Rugën e kalimit para Qendres së Kontrollit
- Objektet e marra në ruajtje me sistem sigurie.
- Qendrën e Kontrollit në ambientet e brendshme dhe të jashtme.

Kamerat regjistrojnë vetëm imazhet që kanë lidhje me qëllimin për të cilin sistemi CCTV është miratuar dhe instaluar.

Në çdo zonë ku janë të instaluar kamera vezhgimi, është vendosur njoftimi në zonë të dukshme nga të gjithë, sipas aneksit të aprovuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhenave personale.

Në ambientet ku janë vendosur këto pajisje lejohet hyrja dhe përdorimi vetëm nga personat e autorizuar nga administratori i kompanisë

Aksesi i pamjeve të regjistruara është i kufizuar vetëm të personat e autorizuar. Të gjitha akseset ose shikimet e pamjeve të regjistruara ndodhin vetëm brenda një ambienti të përcaktuar dhe punonjësit e tjerë nuk lejohen të hyjnë në atë zonë ose të kenë akses ndaj pamjeve.

Kompania jone vendos në dispozicion pamjet vizive ose të dhenat e tjera, që përfitohen nga përdorimi i masave shtesë të sigurisë, me kërkesë të Policisë së Shtetit ose organeve të drejtësisë, vetëm për nevojat hetimore, bazuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në legjislacionin në fuqi.

Të dhenat e mbajtura me anë të sistemit të video survejimit ruhen për një periudhë kohore prej 15 ditësh, dhe pas kalimit të kësaj periudhe, të dhenat fshihen.

Çdo individ ka të drejtën që të njihet me të dhenat personale të përpunuara nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

Çdo person apo subjekt, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhenat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë nderhyrjen e tij për venien në vend të së drejtës së shkelur

Për çdo pyetje apo kërkesë rreth kësaj politike mund të kontaktoni ne:

SH.P.S.F. “Bahiti -G .”

Adresa: Lagjie “Aqif Pasha” Rruga “Rinia” Pallati 495/1 Kati 3 Elbasan.

**Drejtori për Sigurinë  
Gezim Bahiti**